URDHËR
Nr. 43, datë 25.3.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", dhe ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Brendshëm, drejtorit të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, z. Bledar Skënderi, nga data 28.3.2022 deri më datë 30.3.2022, për këtë çështje:

- nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, për fitimin e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë z. Bledar Skënderi.

3. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar, me ndërprerje vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi